VENDIM
Nr. 45/2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 33/2014, "PËR PROCEDURËN PARAPRAKE TË PËRZGJEDHJES SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", si dhe në zbatim të nenit 19, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 33/2014, "Për procedurën paraprake të përzgjedhjes së Komisionerit të Shërbimit Civil", të ndryshuar, në pikën 1, shkronja "a", fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

"a) Nga shërbimet e Kuvendit të bëhet shpallja dhe bërja publike e vakancës së organit të krijuar me ligj nga Kuvendi (në faqen zyrtare të Kuvendit dhe mjetet e informimit publik), për një afat prej 45 ditësh nga publikimi.".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.6.2014